

Më datë

28-04-2018



## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-** Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarin ligjor Blend Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Shtime, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1610-1/17 e dt.24.11.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, i akuzuari, [REDACTED] dhe mbrojtësi me autorizim Av. [REDACTED] nga Prishtina, me datën 20.03.2018 solli dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, i lindur me datën [REDACTED] nga i ati [REDACTED] ëma [REDACTED] e vazëris [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, student, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri me numër personal [REDACTED].

## ËSHTË FAJTORË

Sepse me date 10.08.2017, në rrugën "Tahir Sinani", i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, ashtu që gjatë kontrollit nga ana e policisë, në një veturë taksitë i pandehuri kanë gjetur një qese me substance narkotike e llojit Marihuanë, pas egzamenimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ka rezultuar se substance narkotike është Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahydrokanabinol, me peshë gjithësej prej 1.27 gram,-

*-me të cilën kreu veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së.*

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPK-së të akuzuarin e

## G J Y K O N

Të akuzuarit [REDACTED] i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150/ njëqind e pesë dhjetë / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimin në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1610-1/17 e dt.24.11.2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.20.03.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Sebahate Sinani, i akuzuari [REDAKTUAR] dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av. [REDAKTUAR]

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestara i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dërguarit e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar se në datën e cekur në aktin akuzues me dt.10.08.2016 deri sa ishte me shokun e tij [REDAKTUAR], duke kaluar me taksë nga rrethi te policia në drejtim të Shtimes, i kanë takuar disa persona të cilët i kanë thënë nëse dojnë bari-marihuanë dhe ka pranua duke e blerë një qese me vlerë pre 5Euro dhe gjatë rrugës i ka ndal policia ku i ka gjetur qesen e përmendur pendohet për këtë vepër që e ka kryer, është hera e parë që ndeshet me shkeljen e ligjit, nuk e përdor këtë substancë narkotike, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqyrtimit të sanksionit penal të ketë parasysh pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës penale.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë



vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, ku prokurori është pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR] av. [REDAKTUAR] e mbështetë pranimin e fajësisë së klientit të tij në këtë fazë të procedurës penale, ku pranimin e ka bërë vullnetarisht pas konsultimit me te pendohet për veprën e kryer, dhe ka premtuar se në të ardhmen më nuk do të përdor substancë narkotike i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqipton një dënim më të but ku do të arrihet qëllimi i tij lidhur me rastin konkret.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në deklaratën e tij dhënë në polici me datën 10.08.2017, në Raportin e Ekspertimit të Agjencisë të Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2017-2935/2017-2619 i datës 22.11.2017, vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve të datës 10.08.2017 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka treguar sinqeritet në procedurën penale, pendimin për veprën e kryer, tani më nuk përdor substancën narkotike mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, andaj mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 150/ njëqind e pesë dhjetë / Euro , të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në katër këste mujore në afat prej katër muajsh, si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të

preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e viktmave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
P.nr.3023/17 me datë 20.03.2018

Zyrtari Ligjor  
Blend Rexhepi

Gjyqtari  
Adem Shabani



**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.